

Urdhri i Farmacistëve ka për mision ruajtjen dhe garantimin e nivelit të lartë të formimit dhe edukimit shkencor e profesional të farmacistëve, ushtrimin e profesionit, sipas kërkesave shkencore, normave të etikës mjekësore e të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare dhe mbrojtjen e pacientëve e të konsumatorëve nga keq ushtrimet profesionale dhe shkeljet e normave të detyrueshme.

- Në përmbushje të këtij misioni, Urdhri i Farmacistëve:
  - Bën regjistrimin e farmacistëve në një regjistër të veçantë;
  - Mbikëqyr zbatimin e detyrave profesionale, në përputhje me kërkesat e shkencave farmaceutike dhe të legjislacionit farmaceutik;
  - Bashkëpunon me institucionet arsimore e shkencore për hartimin dhe planifikimin e programeve të formimit shkencor, të specializimit pasuniversitar dhe të kualifikimit të vazhdueshëm të farmacistëve;
  - Mbikëqyr zbatimin e kërkesave të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare, në mbrojtje të interesave të pacientëve dhe të konsumatorëve;
  - Jep dhe heq të drejtën vetjake për ushtrimin e këtij profesioni.

**Shënim:** Lëshim dokumentacioni/Leje/Licenca/Autorizime etje.

**Tarifat e dokumentave që lëshohen nga Urdhri i Farmacistëve si dhe kuotizacioni mujor i anëtarësisë së Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë.**

- Tarifa e anëtarësimit - 10 000 lekë;
- Kuotizacioni mujor për farmacistin e punësuar - 500 lekë;
- Kuotizacioni mujor për drejtuesin teknik - 1 000 lekë;
- Tarifa e ricertifikimit (1 herë në 5 vjet) - 5 000 lekë;
- Riprintim certifikate - 1 000 lekë;
- Tarifa për kryerjen e praktikës profesionale - 10 000 lekë;
- Tarifa për ritestimin e praktikës profesionale - 10 000 lekë;
- Certifikatë e sjeljes së mirë profesionale (vërtetim për jashtë shtetit) - 15 000 lekë.

**Cdo pagese do të kryhet në numrat e llogarive prane bankave si me poshte:**

**BKT: Nr. llog. 4010 69623**

**IBAN: AL6820511014069623CLTJCLALLA**

**Credins: Nr. llog. 00000338610**

**Raiffeisen: Nr. Llog. 0100805804**

**IBAN: AL93202110130000000100805804**